



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI**

Nr. 4062/4 prot.

Pogradec, më 05.11.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj.MANJOLLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, projektin e hartuar, hartat pyjore të ekonomisë për: **“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS”**.

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues të projekt vendimit: 4

Nr. i faqeve A4 të relacionit teknik shpjegues 10

Nr. i fletëve A4 të dokumenteve të projektit planeve të menaxhimit 2: 610

Nr. i faqeve A1 të hartave të Ekonomisë Pyjore Qafë-Panjë dhe Guri i Nikë: 2:11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____, DATË ____ . ____ .2025

PËR

**“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR
EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, nenit 3, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja “k”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 11 pika 2/b të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, i ndryshuar, nenit 14 të Ligjit nr. 111/2024, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”, i ndryshuar, VKM Nr.171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar”, bazuar kontratës Nr.3153/6, datë 11.11.2024 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet, Bashkia Pogradec dhe subjektit “XHET” sh.p.k, Librazhd-Albania, me Nipt **M08429601A**, përfaqësuar nga administratori Xhevdet XHEPI, me objekt: “Hartim Plani menaxhimi ekonomia pyjore “Guri i Nikës” dhe Ekonomia Pyjore “Qafë-Panjë”, si dhe ne vijim të relacionit të përgatitur

nga Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Shërbimit Pyjor), i cili është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, me propozim të Kryetarit,



KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e mbarështimit të ekonomive pyjore “Guri i Nikës” dhe Ekonomia Pyjore “Qafë-Panjë”, të hartuar nga Subjekti “XHET” Shpk me NIPT **M08429601A**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Shërbimit Pyjor) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planit të mbarështimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet.
3. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Shërbimit Pyjor), për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

K R Y E T A R

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 4062 Prot.

Pogradec, më 05.11.2025

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN
ME OBJEKT:
PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR
EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS”.

E NDERUAR KRYETARE E KËSHILLIT!
TË NDERUAR KËSHILLTARË!

KREU I
HYRJA DHE PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË

Ky relacion argumentohet në cilësinë e detyrimit ligjor të Bashkisë Pogradec për administrimin e qëndrueshëm dhe profesional të Fondit Pyjor dhe Kullosor. Synimi është garantimi i zhvillimit të këtij burimi natyror, duke harmonizuar funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Pranë Bashkisë Pogradec është e krijuar dhe funksionon Agjencia Mbrojtjes së Territorit, në të cilën janë të përqëndruara pothuajse të gjitha funksionet e deleguara nga Pushteti Qëndror, të cilat janë:

1. *Shërbimi Pyjor.*
2. Inspektoriat i Pyjeve
3. Sektori i Kullotave.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Pogradec është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **“Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

KREU II

INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE



Ky propozim për Miratimin e planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për ekonomitë pyjore “Qafë-Panjë” dhe “Guri i Nikës”, mbështetet në nenin 27 pika 5, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: **“Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi”**, nenit 54 shkronja “k”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 11 pika 2/b të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, i ndryshuar, nenit 14 të Ligjit nr. 111/2024, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, VKM nr.398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”, i ndryshuar, VKM Nr.171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar”, pika 1, 5 citohet: **“Plani i mbarështimit/inventarizimit është baza e të dhënave për treguesit e fondit pyjor dhe kullosor”**, bazuar dhe kontratës Nr.3153/6, datë 11.11.2024 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet, Bashkia Pogradec dhe subjektit **“XHET” sh.p.k**, Librazhd-Albania, me Nipt **M08429601A**, përfaqësuar nga administratori Xhevdet XHEPI, me objekt: “Hartim Plani menaxhimi ekonomia pyjore “Guri i Nikës” dhe Ekonomia Pyjore “Qafë-Panjë”.

Mbështetur në legjislacionin pyjor në fuqi për pyjet, tregues për gjëndjen e fondit pyjor realizohet vetëm nëpërmjet hartimit të dokumentave strategjik për pyjet, në rastin konkretë, hartimin e planeve të mbarështimit dhe inventarizimit në nivel ekonomive pyjore, e cila është njësia më e madhe e administrimit dhe menaxhimit të fondit pyjor.

KREU III

ARGUMENTET PËR MIRATIMIN

Miratimi Përfundimtar i këtij Plani nuk mund të shtyhet, pasi ai është çelësi për adresimin e menjëhershëm të sfidave kryesore:

1. Legalizimi i Veprimtarisë dhe Lufta ndaj Paligjshmërisë

- **Stop Shfrytëzimit Informal:** Me hyrjen në fuqi të PMPK, Bashkia fiton instrumentin ligjor për të ndërmarrë veprimtari të rregullta shfrytëzimi (prerje, pastrim) dhe për të mbrojtur pyllin. Pa plan, pyjet mbeten të ekspozuara ndaj **prerjeve të paligjshme dhe dëmtimeve**, pasi autoritetet lokale janë të paralizuara në zbatimin e masave proaktive.

- **Kontroll dhe Disiplinë:** Plani përcakton me saktësi *ku, kur dhe sa* lëndë drusore mund të merret. Kjo i jep menaxhuesve pyjorë dhe strukturave të kontrollit një hartë të qartë dhe të padiskutueshme për të disiplinuar veprimtarinë.

2. Përfitimet Financiare të Paanshme

- **Zhvillimi i Buxhetit:** PMPK përcakton **volumin vjetor të prerjes (VAP)**. Miratimi Përfundimtar lejon nxjerrjen e menjëhershme në ankand apo shfrytëzim të këtij vëllimi, duke gjeneruar **të ardhura të reja dhe të pritshme** për buxhetin e Bashkisë, të cilat janë planifikuar për t'u ri-investuar në zhvillimin e zonës.
- **Ekonomia Lokale:** Realizimi i punëve të planifikuara (pastrime, përmirësim i infrastrukturës rrugore pyjore) do të injektojë fonde të drejtpërdrejta në ekonominë lokale, duke krijuar mundësi **punësimi sezonal** dhe mbështetje për bizneset e shfrytëzimit pyjor.

3. Mbrojtja e Mjedisit dhe Menaxhimi i Riskut

- **Parandalimi i Zjarreve:** Plani përcakton zonat e rrezikshmërisë së lartë dhe masat parandaluese, si ndërtimi i brezave të zjarrit dhe pastrimi i materialit djegës. Vetëm me Planin në fuqi, këto punime esenciale mund të nisin menjëherë për të përgatitur pyllin për sezonin e ardhshëm të riskut.
- **Ruajtja e Kullotave:** Plani vendos rregulla të qarta për menaxhimin e qëndrueshëm të kullotave, duke ruajtur kështu biodiversitetin dhe duke garantuar **ushqimin e qëndrueshëm** për blegtorinë lokale.

4. Siguria Sociale (Furnizimi me Dru Zjarri)

Komunitetet rurale varen nga fondi pyjor për nevojat e ngrohjes. PMPK ka llogaritur nevojat e komunitetit për **dru zjarri në bazë të ligjit**. Miratimi i tij mundëson fillimin e procedurave të shpërndarjes së rregullt dhe të kontrolluar, duke ulur presionin shoqëror dhe duke parandaluar shfrytëzimin e rastësishëm.

KREU IV KONKLuzion

Ky Plan i Mbarështimit është frut i punës së ekspertëve të fushës, duke respektuar standardet teknike dhe kërkesat e komunitetit. Miratimi i tij paraprak nga Këshilli Bashkiak nuk është thjesht një detyrim ligjor, por një akt vizionar dhe i nevojshëm që garanton:

1. **Mbrojtjen** e qëndrueshme të burimeve natyrore.
2. **Rritjen** e të ardhurave për Bashkinë dhe komunitetin.
3. **Zbatimin** rigoroz të Ligjit të Pyjeve.

Vonesa në Miratimin Përfundimtar do të thotë:

- Humbje e të ardhurave të planifikuara për Bashkinë.
- Ekspozim i pyjeve ndaj shfrytëzimit të paligjshëm.
- Pamundësi për të ndërmarrë masa parandaluese ndaj zjarrit dhe dëmtimit.

Bazuar në argumentet e mësipërme, —propozojmë:

- Të miratohet Projekt-Vendimi me objekt **"MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS"**, duke i hapur rrugë zbatimit të menjëhershëm të tij.

Ju Faleminderit!

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Konceptoi: E.ANGJELI

A.BRAHO

M.VELILLARI

Pranoi: K.LUFO

Konfirmoi: M.HAFESLLARI

Miratoi: Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 400/14 Prot

Pogradec, më 05/ 2025

RELACION
MBI PROJEKT – VENDIMIN
PËR

**“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR
EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS”**

E NDERUAR KRYETARE KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe me qëllim garantimin e një administrimi të qëndrueshëm dhe efikas të Fondit Pyjor e Kullor të Bashkisë Pogradec, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion teknik i cili argumenton domosdoshmërinë dhe përfitimet e hartimit të Planeve të reja të Mbarështimit për Ekonomitë Pyjore **Qafë-Panjë** dhe **Guri i Nikës**, me përmbajtje si më poshtë:

Baza Ligjore:

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja “k”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 11 pika 2/b të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, i ndryshuar, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, nenit 14 të Ligjit nr. 111/2024, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar, ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në

pronësi të ish Komunave/bashkive”, i ndryshuar, VKM Nr.171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar”,

ANALIZA TEKNIKE DHE GJENDJA AKTUALE E FONDIT PYJOR KULLOSOR

Bashkia Pogradec në kuadër të funksioneve të saj, ka dhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor, kjo sipas listës të përcaktuar me ligj, Sipërfaqja pyjore që administron Bashkia Pogradec, bazuar në VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”, I ndryshuar, janë gjithsej **26,369.88 ha**.

Në zbatim të kontratës nr.3153/6 datë 11.11.2024 “Kontratë Shërbimi” me objekt: “*Hartim plani, menaxhimi ekonomia pyjore Guri i Nikës dhe ekonomia pyjore Qafë-Panjë*”, të hartuar nga subjekti “**XHET**” Shpk.

Gjatë marrjes në dorëzim dhe vlerësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kullosor, që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec është konstatuar se plani i mbarështimit është hartuar për ekonominë pyjore, “**Guri i Nikës dhe Qafë-Panjë**” dhe është mbarështuar për herë të fundit në vitin 2002. Ekonomia gjatë këtyre viteve kanë pësuar ndryshime të mëdha dhe mjaft të ndryshme, si për sa i përket strukturës ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit, sipas klasave të moshës dhe prodhimit. Prandaj duke u nisur nga këto arsye dhe njëkohësisht duke mos mohuar për punën e bërë për hartimin e planit të vjetër, kalimi i një pjese të kësaj ekonomie nga pronë shtetërore në pronësi të bashkisë, ku kërkesat për hartimin e këtij plani janë rritur, u pa e domosdoshme hartimi i këtij plani, i cili do të pasqyrojë gjendjen reale të grumbujve, duke i parë në këndvështrim të ndryshme si ajo e prodhimit, ruajtjes së terrenit dhe me një seriozitet është studiuar gjendja dhe vlerësimi i biodiversitetit në përgjithësi.

Plani i mbarështimit të këtyre ekonomive është hartuar në bazë të manualit të mbarështimit të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si për punimet e terrenit ashtu dhe për ato të zyrës dhe pasqyron gjendjen reale të grumbujve pyjorë.

Në këtë plan mbarështimi një vend të rëndësishëm zë sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyllit.

Objektivi i përgjithshëm është përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve, mbi bazën e kërkesave bashkëkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre, me qëllim që të përcaktohen realisht potenciali i tyre prodhues, duke mbrojtur biodiversitetin dhe mjedisin.

Është synuar ndërtimi i të gjithë faktorëve që lidhen direkt dhe indirekt me tyre, p.sh. popullatat lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, përmirësimi i peisazhit rural, ruajtjen e natyrës. Po ashtu do të synohet plotësimi i kërkesave me lëndë ndërtimi dhe dru zjarri, prodhime të dyta pyjore, bazë ushqimore për blegtorinë.

Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në reference të ligjit nr.57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar, i cili ka përcaktuar afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarështimit për një afat 10 vjeçar.

Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputhje me politikat dhe Programin Kombëtar të Pyjeve, duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për zhvillimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare.

Mbarështimi i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar, si dhe me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit. Shfrytëzimi dhe përdorimi i resurseve natyrore, është vlerësimi i drejtë i pyjeve të kësaj ekonomie, në të njëjtën kohë është dhe një hap para dhe si faktor i domosdoshëm për ruajtjen e ekuilibrit të mjedisit, e në të njëjtën kohë është dhe një rregullator i mirefillte në ruajtjen e regjimit hidrik.

Është detyrë përcaktore që me zbatimin e masave silvoteknike që do të hartohen e zbatohen në këtë plan mbarështim që grumbujt pyjorë të arrijnë qëllimin kryesor të final, sipas regjimit të tij.

Synimet që do të arrihen në zbatimin e këtij plani janë:

- Hartimi i masave silvoteknike në trajtimin e pyjeve që, do të shprehet dhe në rritjen e prodhimtarisë së të gjitha elementeve të duhura.
- Menaxhimi me kritere të efektshme ekonomike me efektivitet të qëndrueshëm ekonomik gjatë shfrytëzimit racional të burimeve natyrore
- Hartimi dhe miratimi i këtij projekti është baza e fillimit të ushtrimit të masave silvoteknike, dhe kryerja e një menaxhimi të mirefillte të të ardhurave ekonomike, e një të ardhme të një grumbulli pyjor me parametra të prekshme.

Gjatë tranzicionit dhe periudhës së tanishme, pyjet nuk janë trajtuar mirë sipas planeve të mbarështimit, në përgjithësi pyjet janë demtuar nga prerjet pa leje, kjo vjen si rezultat i mungesës së lëndës djegëse (dru zjarri), dhe varferisë të komunitetit që jeton brenda ekonomisë pyjore.

Planet e mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, janë të vlefshme për një periudhë 10-vjeçare. Ato hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për

të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përfundimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të sektorit të pyjeve e kullotave të bashkise përkatëse:

1). FONDI PYJOR DHE KULLOSOR SIPAS EKONOMIVE PYJORE SI DHE KATEGORITË E PËRDORIMIT TË TOKËS BRENDA TERRITORIT TË EKONOMISË PYJORE GURI I NIKËS.

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarështimit 2025-2034

Përdorimi i terriorit

Sip. totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Sip.Bimësi Pyjore (ha)	Sip.Bimësi Pyjore (%)	Tjetër (ha)	Tjetër (%)
1224.5	1010.5	82.52	193.8	15.83	3.5	0.28	16.8	1.37

Format e qeverisjes

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP Guri i Nikës	Plani i mëparshëm Inventarizimit_2002		PMPK aktual	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	1082.79	82.37	949	78.80
Cungishte	11.9	0.91	61.5	5.11
Shkurre	0	0	0	0
Kullota ,livadhe	219.79	16.72	193.8	16.09
Gjithsej	1314.48	100	1204.3	100

Nga analiza vihet re se, kemi pakësim të sipërfaqes në formën e përdorimit “Pyje Trungishte” me 133.79 ha si dhe më pak dhe në kullotë 25.99 ha, si dhe një shtesë në formën e qeverisjes Cungishte me 49.6 ha. Por referuar VKM Nr.591 datë 25.09.2024 “Për shpalljen Peisazh i Mbrojtur” (kategoria e V-të) të zonës Guri i Nikës valamarë-Lenie” e cila me ndryshimin e kufirit të zonë së mbrojtur dhe me kërkesë të ADZM, është bërë e mundur mos inventarizimi i ngastrave që u preken nga kufiri i ri dhe pakësimin në sipërfaqe, e cila ka marrë sipërfaqe nga territori brenda konturit të ekonomisë pyjore Guri i Nikës kjo është dhe arsyeja e pakësimit në sipërfaqe në raport me administrimin bashkiak.

Tipet e kullotave

Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave prej 193.8 ha në EP Guri i Nikës është ndarë sipas tipeve dhe shkallës së mbulesës barishtore. Tabelat dhe grafikët më poshtë evidentojnë gjendjen mesatarisht të mirë të tokave kullimore, pasi më së shumti janë të përziera me drurë dhe bimësi të rrallë pyjore dhe për shkak se 57% e sipërfaqes kullimore ka një mbulim me vegjetacion më pak se 80%.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja e tokës kullimore (ha)
Kullotë	162.72
Kullotë me drurë	31.08
Kullotë me shkurre	0
Livadh	0

Ne ekonomine pyjore EP Guri i Nikës përfshihet një sipërfaqe prej 193.8 ha kullota alpine Ballkanike. Periudha e kullotjes është vetëm gjatë verës. Për shkak të numrit të krereve të bagetisë dhe përdorimit kolektiv të saj ka një rendim të kullotës. Shfrytëzimi bëhet duke u dhënë liri kopeve të dhenjve të gjejnë ushqim sipas dëshirës së tyre në të gjithë sipërfaqen dhe për gjithë sezonin kullor.

Në total ekonomie, për formën e qeverimit tërësisht, do të përshkohen me ndërrhyrje silvikulturale 297.7 ha, nga ku do të rezultojnë 5702.6 m³ lëndë drusore.

Do të kryhen tre tipe të ndërrhyrjeve silvikulturale:

- Rrallime tip I**, të cilat do të aplikohen në 171.37 ha, nga ku do të përfitohen 2062.84 m³ lëndë drusore. Ndërrhyrjet në këtë tip janë planifikuar të shtrira në 10 vite sipas urgjencave 2 (4- 7 vjet ose 2029, 2030).
- Shfrytëzime-Prerje sanitare**, ku gjatë kësaj ndërrhyrje do të hiqen drurët e nënshtruar të shtrembët e që paraqesin probleme, duke krijuar hapësirat e nevojshme për intensifikimin e rritjes së grumbullit. Kjo lloj ndërrhyrjeje do të aplikohet në 93.03 ha dhe nga ku do të përfitohen 1808.8 m³ lëndë drusore. Sikurse cituam edhe më lart, punimet janë të shpërndara përgjatë 10 viteve në të cilën ky plan do të ketë fuqi ligjore dhe përfshin urgjencën 1, 2.
- Përfundimtare**, do të aplikohet në një sipërfaqe prej 33.26 ha dhe një volum prej 1830.9 m³, gjatë vlersimit dhe gjëndjes aktuale, çmohet se filizëria ka arritur të formojë në të gjithë sipërfaqen gjëndjen e masivit, në këtë rast do të vilen drurët e fundit në këmbë nga grumbulli i moçëm, për të dhënë liri dhe prioritet zhvillimit të grumbullit të ri.



Nr	Lloji i punimit	Njësia	Sasitë (sipas ndërhyrjeve në 10 vjet)
1	Prodhim i lëndës drusore	m ³	20172
2	Pyllëzim	ha	5.33
3	Blerje fidanësh	copë	17764
4	Masat në Kullota	ha	54.46
5	Masa Infrastrukture	km	13.6
	Gjithsej		

Këto rrallime do të aplikohen me intensistete të ulët dhe të mesëm i prerjeve. Materiali drusor që do të nxirret nga ndërhyrjet silvoteknike me intensitet të ulta dhe pak të mesme në planin 10 vjeçar të punimeve.

Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, pasi të dhënat u bartën në programin e përpunimit të të dhënave MS Access DB, të miratuar nga Këshilli Shkencor i ish Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave në vitin 2000, rezultoi se EP Guri i Nikës ka një volum të përgjithshëm në këmbë prej 82360.4 m³. Ashtu si më sipër kemi theksuar, volumi i përket vetëm formave të qeverimit Trungishte dhe Cungishte.

Të dhënat për shpërndarjen e volumit jepen në tabelën më poshtë.

Forma e qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar m ³ /vit	Vol. total në këmbë (m ³)	Rritja mes. vjetore (m ³ /ha/vit)	Rritja mes vjetore total shtrese (m ³ /ha/vit)
Trungishte	949	83.91	79629.8	3.8	3601.31
Cungishte	61.5	44.41	2730.6	2.74	168.24
Gjithsej	1010.5	0	82360.4		

Të dhënat që vijnë nga përpunimi i të dhënave në programin MS Access DB për format e qeverimit të gjendura në EP Guri i Nikës.

Këto të dhëna të rritjes vjetore për shtresën e pyjeve në formën e qeverimit “Trungishte”, tregojnë se planifikimi i ndërhyrjeve në këto grumbuj është i drejtë dhe se do të çojë në intensifikimin e rritjes së grumbullit.

2.FONDI PYJOR DHE KULLOSOR SIPAS EKONOMIVE PYJORE SI DHE KATEGORITË E PËRDORIMIT TË TOKËS BRENDA TERRITORIT TË EKONOMISË PYJORE QAFË-PANJË.

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarwshtimit 2025-2034

Përdorimi i territorit

Ekonomia Pyjore Qafë-Panjë		
Përdorimi i tokës (ha)	Përdorimi i tokës (bazuar në VKM)	Sipas Planit të Mbarështimit 2025
Pyll	1149.48	1269.6
Kullotë	245.9	288.6
Sipërfaqe me bimësi pyjore	115.1	32.4
Djerr	40.2	1.7
Inproduktive	49.91	20.8
Gjithsej	1600.59	1613.1

Ashtu sikurse vërehet, ka një Shtesë prej 12.51 ha në total të sipërfaqes së ekonomisë pyjore, krahasuar me sipërfaqen e dhënë në VKM. Kjo shtesë vjen për arsyet e mëposhtme:

Diferenca prej 12.51 ha ndërmjet sipërfaqes së përcaktuar në VKM dhe asaj të dalë nga plani i mbarwshtimit 2025 nuk është vetën rrjedhojë e matjeve të sakta në GIS gjeoreferencimit të konturit të parcelave, nënparcelave, por gjithashtu tregon një rishikim të funksioneve të territorit.

-Një pjesë e sipërfaqeve që më herët ishin të llogaritura si të papërdorshëm, ose të paqarta janë përfshirë në kategorite e këtij plani, gjatë inventarizimit si dhe suksesioni natyror pozitivë nëpërmjet ripërtëritjes ka ndikuar pozitivisht në shtesë sipërfaqe/ha.

-Ky rishikim pasqyron përdorim racional të burimeve natyrore, duke nxjerr në pah rolin e inventarizimeve të reja në planifikim afatëgjatë.

-Shtesa e vogël prej 12.51 ha në raport ndaj sipërfaqes së përgjithshme është 0.78 %, tregon një tendencë pozitive drejt harmonizimit të të dhënave me realitetin në terren.

Format e qeverisjes

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP Qafë Panjë	Plani i mëparshëm Inventarizimit_2002		PMPK aktual	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	610.52	41.23	329.8	21.17
Cungishte	621.64	41.99	939.8	60.31
Shkurre	0	0	0	0
Kullota ,livadhe	248.45	16.78	288.6	18.52
Gjithsej	1480.61	100	1558.2	100

Nga analiza vihet re se, kemi pakësim të sipërfaqes në formën e përdorimit “Pyje Trungishte” me -280.72 ha si dhe në kullotë një shtesë prej +40.15 ha, si dhe një shtesë në formën e qeverisjes Cungishte me +318.16 ha. **Forma e qeverisjes Tungishte e cila** ka pësuar një **pakësim të ndjeshëm prej 280.72 ha**, duke kaluar nga 610.52 ha në vetëm 329.8 ha. Kjo humbje lidhet ngushtë me **prerjet e paligjshme** të cilat kanë ndikuar në uljen e densitetit të drurëve, si dhe me **zjarret pyjore** që kanë dëmtuar sipërfaqe të konsiderueshme, duke shkatërruar strukturën e pyllit. **Forma e qeverisjes Cungishte e cila** ka një **rritje dominuese prej 318.16 ha**, duke u rritur nga 621.64 ha në 939.8 ha. Ky ndryshim tregon procesin e transformimit të trungishtes në cungishtë, për shkak të shfrytëzimit të pyjeve. Pas prerjes apo djegies, pylli rigjenerohet në formë cungishtë. Pra, **prerjet dhe zjarret** kanë nxitur kalimin e pyllit nga një formë më cilësore (trungishtë) në një formë më të degraduar (Pyll i mesëm cungishtë). **Kullota dhe livadhe** ka një **shtesë prej 40.15 ha**, nga 248.45 ha në 288.6 ha. Kjo lidhet me faktin që zonat e prekura nga zjarret dhe prerjet shpesh kthehen në hapësira të zhveshura, të cilat shfrytëzohen më pas si **kullota**. Ky fenomen është i dukshëm në zonat malore ku presioni i bagëtive dhe mungesa e masave rigjeneruese nxisin shndërrimin e pyllit në kullotë.

Si perfundim themi se sipërfaqja e përgjithshme ka një shtesë prej 77.59 ha, e cila lidhet kryesisht me matjet më të detajuara të bëra në planin e ri dhe përfshirjen e disa zonave të mëparshme të pa evidentuara.

Tipet e kullotave

Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave prej 288.6 ha në EP Qafë Panjë është ndarë sipas tipeve dhe shkallës së mbulesës barishtore. Tabelat dhe grafikët më poshtë evidentojnë gjendjen mesatarisht të mirë të tokave kullosore, pasi më së shumti janë të përziera me drurë dhe bimësi të rrallë pyjore dhe për shkak se 61% e sipërfaqes kullosore ka një mbulim me vegjetacion më pak se 78%.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja e tokës kullosore (ha)
Kullotë	179.97
Kullotë me drurë	108.63
Kullotë me shkurre	0
Livadh	0
Totali	288.6

Këto janë të gjitha punimet që do të impelentohen gjatë zbatimit dhe impelentimit në EP Qafë-Panjë, sipas tabelës së mëposhtme si rrallime që do të aplikohen me intensitete të ulët dhe të mesëm i prerjeve. Materiali drusor që do të nxirret nga ndërhyrjet silvoteknike me intensitet të ulta dhe pak të mesme në planin 10 vjeçar të punimeve, pyllëzime në vendet e eroduara, përmirësimi i rrugëve auto për aksesimin edhe në rastet e zjarreve në pyje, krijimin e koridoreve etj.

Nr	Lloji i punimit	Njësia	Sasitë (sipas ndërhyrjeve në 10 vjet)
1	Prodhim i lëndës drusore	m ³	11195
2	Pyllëzim	ha	0.93
3	Blerje fidanësh	copë	2325
4	Masat në Kullota	ha	163.7
5	Masa Infrastrukture	km	8.6
Gjithsej			

Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, pasi të dhënat u bartën në programin e përpunimit të të dhënave MS Access DB, të miratuar nga Këshilli Shkencor i ish Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave në vitin 2000, rezultoi se EP Qafë-Panjë ka një volum të përgjithshëm në këmbë prej 30832.8 m³. Ashtu si më sipër kemi theksuar, volumi i përket vetëm formave të qeverimit Trungishte dhe Cungishte.

Të dhënat për shpërndarjen e volumit jepen në tabelën më poshtë.

Forma e qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar m ³ /vit	Vol. total në këmbë (m ³)	Rritja mes. vjetore (m ³ /ha/vit)	Rritja mes vjetore total shtrese (m ³ /ha/vit)
Trungishte	329.8	48.36	15948	4.78	1576.28
Cungishte	939.8	15.84	14884.8	0.76	549.47
Gjithsej	1269.6	0	30832.8		

Këto të dhëna të rritjes vjetore për shtresën e pyjeve në formën e qeverimit “Trungishte”, tregojnë se planifikimi i ndërhyrjeve në këto grumbuj është i drejtë dhe se do të çojë në intensifikimin e rritjes së grumbullit.

Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, fondi pyjor dhe kullosor qeveriset bazuar në planet e mbarwshtimit që përbëjnë dokumentet bazë për mbarwshtimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjëndjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

Plani i ri i mbarwshtimit të ekonomisë pyjore përcaktohen hapat që do të ndiqen për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare, duke i hapur rrugë në këtë menyrë investimeve në fodin pyjor dhe kullosor nëpërmjet:

- Pyllëzimeve të reja dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara
- Shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve për nevojat publike

- c) Rritjen e mundësive për mbrojtjen e shtresës së tokës nga gërryrjet/ erozioni
- d) Rritjen e prodhimit të lendës drusore

Nga ana tjetër përmes këtij procesi arrijmë të realizojmë plane të tilla për pyjet, të cilët janë një bazë e mirë për certifikimin e pyjeve të bashkisë bazuar në rregulloret FLEGT dhe EUTR të BE-si dhe ligjin Nr.57 datë 30.04.2020 "Për pyjet" duke garantuar në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në territorin e bashkisë.

Referuar nenit 11, pika 2 shkronja "b" të ligjit 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", i ndryshuar, përcaktohet se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore janë dokument bazë afat gjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, të vlefshme për një periudhë 10-vjeçare, hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përfundimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës.

Në këto kushte, Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (struktura e shërbimit pyjor) në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e çështjeve që lidhen me hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen, zhvillimin, shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor e kullosor pjesë e territorit të Bashkisë Pogradec, me qëllim arritjen e objektivave të saj strategjike dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative, ***i propozon Këshillit Bashkiak Pogradec për miratimin e tij si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në cilësinë e organit vendimarrës, miratimin përfundimtar të Projekt Draft planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Guri i Nikës dhe Qafë-Panjë.***

1. Mbarështimi është planifikimi afatgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuar për grumbullimin e informacionit për situatën/ gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat administruese, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.
2. Ekonomi pyjorë është njësi bazë e organizimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar për qeverisjen e pyjeve dhe drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarështimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor, me kufij të qartë natyrorë.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: E.ANGJELI

A.BRAHO


M.VELILLARI

Pranoi: K.LUFO

Konfirmoi: M.HAFESLLARI

Miratoi: D. BABASULI

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 4062/Prot
14

Pogradec, më 05.11.2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR
"MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR
EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS "

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, "Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja "a" përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të

miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon: "**Akt normativ nënligjor**" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. "Akti administrativ":

a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe, me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike dhe krijon administrimin e qëndrueshëm dhe profesional të Fondit Pyjor dhe Kullosor dhe synimi i të cilës është garantimi i zhvillimit të këtij burimi natyror, duke harmonizuar funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në territorin e Bashkisë Pogradec.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI